

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: Meremetimi i Institucioneve Arsimore

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Restaurime –
kodi 45454100-5**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 24,083,301.88 (njëzet e katër milion e tetëdhjet e tre mijë e treqind
e një mijë pikë tetëdhjet e tetë) lek pa tvsh**

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor N.SH.M.A.C Bashkia Korçë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura perzgjedhese e prokurimit qe do te perdoret ne kete tender eshte percaktuar sakte ne urdherin e prokurimit: "Tender I hapur".

Procedura e prokurimit eshte mbi kufirin e ulet monetar dhe nen kufirin e lartë monetarë

Në përputhje me nenin 33 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650.000.000 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40.000.000 (dyqind milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatoret ekonomik pjesemarres ushtrojne veprimtarine e tyre konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe ato te energjise elektrike sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike per realizimin e objektit te prokurimit dhe merre persiper çdo rrezik qe mund te ndodhe, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, **në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku percaktohet se: ” Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që

garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkojë. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këtë procedurë është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jetë minimalisht sa vlera e parashikuar e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” *”Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit

pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave Vendore”* (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre

Kjo kerkese eshte vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar.

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:*

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Situacionperfundimtar punimesh
- Fatura tatimore që i korespondon situacionit perfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën

me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve..

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës inxhinier, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.P - 1	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P - 2	A	Ndertime civile dhe industriale
N.P - 3	A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash
N.P – 4	A	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.S- 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S- 2	A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
N.S - 4	A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese

Operatori ekonomik duhet te paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme ne zbatim, ne veprimtari nderhyrese ne pasurite kulturore materiale, ne kategorine

N-Z/A/7. Zbatim në konservim,restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rruge,sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë, (ose Ministrise kompetente

te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licensave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategori në respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gërmimi në tokë	Germim dheu me krah Mbushje kanali me dhe Transport mbeturina 5 km	0-20 mln leke	
N.P-2 A	Ndertime civile dhe industriale	Shtrese betoni C16/20 Ndertim mur tulle I plote M-25 Beton per themel bordure C12/15 F.V. bordura betoni 30/15 cm	0-20 mln leke	
N.P-3 A	Rikonstruksi on dhe mirembajtje	Lyerje me hidrokroma me ngjyre Lyerje me cimentokrome me ngjyre (fasada) Lyerje me hidrohroma brenda F.V. pllaka gres per shtrese	0-20 mln leke	

	godinash civile e industriale, veshje fasadash	Veshje muri me pllake qeramike (banjo) F.V. pllaka veteshtrenguese per oborre F.V. pragje mermeri Zhbllokim oxhaku Veshje xokolature me pllaka guri Pastrim Ulluqe Suvatim fasade me grafiato+termoizolim(kapote)		
N.P-4 A	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtrese stabilizant per pllaka oborri 5 cm	0-20 mln leke	
N.S- 1. A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje mur tulle pa pastrim Prishje sipërfaqe me pllaka (dysHEME+mure) Prishje suva muri jashte dhe brenda Prishje shtrese betoni trotuar	0-20 mln leke	
N.S- 2. A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	F.v. tubo pvc per banjo d=140-200m/m F.V. ËC allafrenga importi porcelani F.V. lavaman porcelani importi me mishelator F.V. tubo PE 100PN d=40m/m F.V. tubo PE 100PN d=20-25 m/m F.V. tubo plastike d=125 m/m F.V. tubo plastike d=110 m/m F.V. tubo plastike d=50 m/m F.V. tubo plastike d=40 m/m F.V. pileto dysHEMEJE d=50 m/m F.V. saraqineske d=1/1/2= 40m/m F.V. saraqineske d=1" = 25 m/m F.V. saraqineke kendore	0-20 mln leke	
N.S-4. A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te	Berje suva e brendshme Lluster cemento 1:3, me trashesi 3 cm Ndrim+mbulim cati me tjegulla importi Suvatim mur tulle oxhaku I thjeshte(jashte) Berje suva e jashtme e thjeshte F.v. dyer duralumini (banjo)+ vetrate tek xham Suvatim mur guri me llac cemento F.v. ulluk vertikal llamarine F.V. kaseta llamarine Tavan me rrjete teli +suva Fugatim mur guri me llac cemento1:2 Berje cati (fallco) me tjegulla importi F.V. ulluke horizontal llamarine	0-20 mln leke	

	natyres teknike ndertuese	F.V. impjuve llamarine (cati) F.V. dyer duralumini dopjo xham te jashtme		
--	---------------------------	---	--	--

Operatori ekonomik duhet te paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme ne zbatim, ne veprimtari nderhyrese ne pasurite kulturore materiale, ne kategorine

N-Z/A/7. Zbatim në konservim,restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rruge,sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane

Argumentimi: Baza ligjore Ligji nr.9048, date 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” te ndryshuar dhe Rregullore për “Kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e liçensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”. Kriteri për licencës e kategorisë N-Z/A/7, është lidhur me vendodhjen e disa prej objekteve te cilat rezultojne te jene brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane, Gjithashtu eshte e lidhur me zerat e punimeve dhe nderhyrjet në zonat e mesiperme trashëgimise kulturore apo natyrore fizike e demtuar si ndertesa apo vende/objekte historike ne natyre (mulli, vend kuvendimi,monumente të trshëgimisë historike.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Restaurues 1 (një)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet te jetë ne Listëpagesat te pakten për periudhen Maj 2023 si dhe te figurojne në licensën e shoqërisë. Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë noteriale pune e vlefshme
- -diplomat përkatëse.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zerat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në

realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit ,hidroteknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Inxhinieri i mjedisit është vendosur me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit të lidhur ngushtësisht me punimeve e parashikuara në preventiv dhe përshkrimin e relacionit teknik Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

1 (nje) Inxhinier Ndërtimi	Punime ndertimi/ Punime Germimi dhe Prishje
1 (nje) Inxhinier Hidroteknik	Punime hidrosanitare ne referim termat e references
1 (nje) Inxhinier Restaurues	Punime fasadash dhe te tjera lidhur me to per objektet brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane

2.3.4 Operatori ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1(një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 ”Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar), i cili të ketë kontratë pune, diplomë, licensë Urdhër Mjeku dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Maj 2023 dhe në vazhdim

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)

Njëkohësisht në përputhje me Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011 ” Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.

*Sipas kësaj VKM, AK do të pranojë që nëse punëdhënësit nuk kanë persona të ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura për të realizuar detyrat lidhur me çështjet e shëndetit në punë (dmth nëse nuk ka mjek të punësuar), **mund t’i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim***

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë

autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 3, pika 3, të Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Ligjin Nr.10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" (i ndryshuar), VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" (i ndryshuar) i cili percakton "2/1. Pundhësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nepermjet mjekut të ndennarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike dhe12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të kësaj vendimi, marrja në punë e mjekut të ndennarrjes është e detyrueshme për ato ndennarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës ... Mjeku i ndermarrjes ofron këshillimin e tij për problemet e mbrojtjes në punë, për shmangien e aksidenteve dhe të semundjeve profesionale, si dhe për të gjitha çështjet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë. Ai vlerëson çështjet e fiziologjisë së punës, të problemeve higjienike e sanitare, veçanërisht të ritmit e të kohës së punës, të organizimit të vendit të punës, të zhvillimit dhe të mjediseve të punës

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar një numër prej 16 punonjësish për realizimin e kontratës objekt prokurimi. Rrjedhimisht kërkesa e AK që Oe të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm, është në përputhje me nenin 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë", i ndryshuar

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- *1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", e dhënë nga një organizim i licencuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës.*
- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën një punonjës si "Ekspert zjarrfikës" në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Për këtë duhet të paraqitet Certifikate/dëshmi për ekspert zjarrfikës të leshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata noteriale e punës.*
- *1(një) Punonjës Specialist të Certifikuar dhe trajnuar për Punimet në lartësi.D.P.I. Renia nga lartësi, punime në fasadë, etj sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" e dhënë nga një organizatë certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Për këtë duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimit e dhënë nga një organizim i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë punë e vlefshme*

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, vendosja e këtij kriteri mbështetet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4.1, ku përcaktohet se *drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.*

Së treti duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”* si dhe pikës 2.1 ku citohet se *“drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.*, gjithashtu jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: *“Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjesi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimit”*.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”* dhe pika 2: *“elementët e licensës”* gërma “c” ku citohet se: *“Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”*.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit si Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete një punonjës si “Ekspert zjarrfikës” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Per kete duhet te paraqitet Certifikate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.
- 4 (kater) Punonjes Specialist te Certifikuar dhe trajnuar per Punimet ne lartesi.D.P.I. Renia nga lartesite, punime ne fasade, etj sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” e dhenë nga një organizate certifikimi e akredituar shqiptar ose e huaj. Per keto duhet të paraqitet :certifikata/dëshmi trajnimi e dhënë nga një organizëm i licensuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontratë pune e vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.6: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurise e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve profesionale ne ndermarrje /institucion, dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rëndesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësim të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënëz zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Gjithashtu kërkesa për Ekspert zjarrfikës është në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", duke patur parasysh që një zë i rëndësishëm në preventiv është edhe Sistemi i Mbrojtjes kundër Zjarrit

Nisur nga funksioni i tij, objekti i parashikuar të ndërtohet duhet të plotësojë minimalisht standardet infrastrukturore në fuqi, kundrejt institucioneve të arsimit të lartë. Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre", Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi d):

d) Të gjitha objektet, që do të shërbejnë si institucione të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

Projekti i zbatimit përmban të gjitha masat aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri, të paraqitura në materialet grafike të të gjithë projekteve, si dhe në preventivin e punimeve, grafikun, relacionet dhe specifikimet teknike përkatëse. Masat për mbrojtjen nga zjarri përmbledhen në projektin e mbrojtjes nga zjarri. Zbatimi i saktë i të gjitha masave dhe punimeve për mbrojtjen nga zjarri është dmosdoshmëri dhe detyrim.

Në mbështetje të Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", neni 39, pika 3, projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Referuar nenit 42 të po këtij ligji, moszbatimi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në konstruksionet, objektet e ndërtimit, në ndërtesa të çdo lloji apo aktivitete që ushtrohen në to, ngarkon me përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, personat fizikë e juridikë që i kanë ato në pronësi ose në administrim.

Për ndërtimin e ndërtesës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2015, më sipër cituar dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, është e nevojshme që të angazhohet 1 (një) ekspert zjarrfikës, i cili duhet të jetë pjesë e stafit inxhinierik të OE.

Duke iu referuar preventivit të pasqyruar në DST parashikohen ngritje skelash dhe punime në to, në lartësi nga 5m deri 15 m Kjo kërkesë e AK lidhet me faktin se projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon punime fasade dhe punime për realizimin e

konsolave me hapsira të konsiderueshme. Si rezultat i kësaj procedure do të realizohet një objekt me lartësi deri 15 m dhe rënia nga një lartësi e tillë e individëve apo materialeve përbën rrezik shumë të madh për jetën dhe shëndetin e personave të pranishëm në kantier. Numri prej 4 (kater) punonjësish, nënkupton se për realizimin e tre vëllimeve/objekteve ndërtimore me sipërfaqe fasade 6150 m2 është minimale.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 16 (gjashtëmbëdhjetë) persona për muajin Maj 2024 të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave .
- Listepagesat e deklaruara në organet tatimore bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve” për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Shënim: *Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor*

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për muajin e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave j, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 23 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.*

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos(material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Kete perlllogaritje si nevoje e transparences ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

ANALIZA E FUQISE PUNETORE

MEREMETE OBJEKTET ARSIMORE VITI 2024

Nr	Nr. An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ORE PUNE	VLERA
1	2.404	Boje hidroplastike	m2	40100.0	0.36	14436
2	2.401	Boje vaji siperfaqe metalik	m2	257.0	1.47	377.79
3	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	1.0	2.2	2.2
4	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendshem	m2	100.0	0.24	24
5	3.197/2	Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm.	m2	10.0	0.755	7.55
6	2.310	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	332.0	0.755	250.66
7	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	200.0	3.7	740
8	2.314/1	Suva trare e kollona ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	130.0	0.8	104
9	2.355/b	Veshje fasade me pllaka guri	m2	30.0	10.9	327
10	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle ~8m	m2	222.0	0.755	167.61
11	2.312	Suva brenda mur guri ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m2	10.0	1.75	17.5
12	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	4.0	8.6	34.4
13	2.277	Shtrese lluster çimento 1:2, t=30mm	m2	60.0	0.66	39.6
14	2.64/1	Mur me tulla te plota zak deri 3m, llaç perzier M 15	m3	3.0	11	33
15	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2	155.0	2.46	381.3
16	2.294/2	Vendosje pllaka betoni trotuari ekzistues	m2	10.0	3.8	38
17	2.395	Dyer d/alumini tek xh.	m2	75.0	2	150
18	2.395/1	F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	10.0	2.67	26.7
19	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	43.0	0.8	34.4
20	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	120.0	1.09	130.8
21	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	332.0	1.3	431.6
22	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	copë	4.0	2.42	9.68
23	2.216	Çati vendi me 1 kullim HD~7m, tjegulla marselieze	m2	842.0	2.3	1936.6
24	2.203	Veshje kornize llamarine xingat	m2	46.0	1.6	73.6
25	2.501	F.V ËC allafrenga	copë	8.0	3.7	29.6
26	2.631	F.V Lavamane porcelani	copë	10.0	2.95	29.5
27	2.227	F.V Kabine dushi 80 x 80 cm e thjeshte	ml	4.0	4.3	17.2
28	2.491/2 d	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PEd=40mm, t = 3.0 mm, Pn 10	ml	30.0	0.3	9

29	2.491/2 b	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PEd=25mm, t = 2.0 mm, Pn 10	ml	18.0	0.3	5.4
30	2.491/i	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PEd=125mm, Pn 16	ml	34.0	1.66	56.44
31	2.491/h	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PEd=110mm, Pn 16	ml	22.0	1.43	31.46
32	2.491/e	FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PEd=50mm, Pn 16	ml	14.0	0.8	11.2
33	2.515	F.V pilete dyshemeje Ø 50	copë	10.0	1.7	17
34	2.494/4	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm	copë	12.0	1.2	14.4
35	2.494/2	F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	copë	4.0	1.2	4.8
36	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	copë	3.0	1.2	3.6
37	2.523/1	F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	ml	10.0	0.242	2.42
38	2,109	Themel e xokol betoni C 12/15	m3	3.0	2.6	7.8
39	2,121	Breza b/a monolit C 16/20	m3	3.0	18.76	56.28
40	2,118	Kollona b/a monolite C 16/20 h ~ 8m	m3	2.0	32.97	65.94
41	1.126/p	Bordura betoni 15x35cm	m	40.0	1.06	42.4
42	2.52/2	Mur guri themel e xokol me llaç te perzier M 25	m3	28.0	7.6	212.8
43	2.88	Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15	m3	8.0	10	80
44	3.604	F.V kangjell ne trotuar (struktura metalike e lyer me boje) ne zonat eshkollave	ml	52.0	1.47	76.44
45	An1	Lyerje çimentochroma fasade	m2	2990.0	0.36	1076.4
46	An2	Lyerje me hidrochroma brenda	m2	35000.0	0.36	12600
47	An3	Prishje shtrese dhe veshje pllaka	m2	245.0	0.42	102.9
48	An4	Ndrim+mbulim çatie tjegull importi	m2	621.0	2.3	1428.3
49	An5	Pastrim oxhake	copë	181.0	1.6	289.6
50	An6	Pastrim ulluke	ml	2974.0	0.24	713.76
		SHUMA				36758.63
		Specialist (70%)				25731.041
		Puntori (30%)				11027.589
		Specialiste dite pune				3216.3801
		Puntori dite pune				1378.4486
Specialist Punetor			11 punonjës 5 punonjës			

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Teknik Ndërtimi 1 (nje)
- Specialist Ndertimi 1(nje)
- Hidraulik 1 (nje)
- Muratore 1 (nje)
- Suvatues 1 (nje)
- Bojaxhi 1 (nje)

- Pllakashtrues 1 (nje)
- Hidroizolues 1 (nje)
- Punime durale 1 (nje)
- Karpentier 1 (nje)

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Korrik 2024 dhe në vazhdim

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (nje) manovrator për eskavator si dhe 1 (nje) shofer të mjeteve të renda.

Për manovratorin deshmitë e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Korrik 2024 - dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues

Për shoferin me leje drejtimi të vlefshme deshmi të kualifikimit të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, libere pune dhe të figurojnë në listëpagesa për periudhën Maj 2024 dhe në vazhdim ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen sëbashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues

Shënim: Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor

Argumentim Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Percaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afatëve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore

2.3.9 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Kamion 3.5 - 7.5ton	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Autovinc me kosh	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Eskavator	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Fadrom (kove para dhe krahe mbrapa)	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Rrul me vibrim	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantier	copë 1	Ne pronesi ose me qera
Matrapik min 1500Ë	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Motogjenerator	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Depozite 2000-5000 lit	cope 1	Ne pronesi ose me qera
Skele	2000 m2	Ne pronesi ose me qera
Rrjete mbrojtese	2000 m2	Ne pronësi ose me qira
Pompe suvatimi	cope 2	Ne pronësi ose me qira
Pomp lyerje	cope 2	Ne pronësi ose me qira

Mjete mbrojtese		
Kokore	23 cope	Ne pronesi ose me qera
Fikse Zjarri	10 cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela Sigurimi Teknik	20 cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	23 cope	Ne pronesi ose me qera
Kuti Ndhme e shpejt	4 cope	Ne pronesi ose me qera
Prozhektor per ndricim	2 cope	Ne pronesi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënsit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9.

Shënim: Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës *bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).*

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë:

- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent
- OHSAS 18001- 2007 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose certifikatën me standardin e azhurnuar dhe ekuivalent të njohur nga Standardet shqiptare ISO 45001-2018 - ose ekuivalent
- ISO PAS 99:2012 (Për sistemin e integruar të menaxhimit)(ose e perditesuar)

Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.

Argumentim:: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

ISO 45001 : 2018 - Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, Ak duhet të sigurohet se Oe zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Certifikata **ISO 45001 : 2018** dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

ISO 14001:2015 - Sikurse vëren edhe VNM e pregatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të pregatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

ISO PAS 99:2012 është standart ndërkombëtar për sistemin e integruar të menaxhimit. Është një standard për shkrimin e standardeve të sistemit të menaxhimit të i bazuar në kushtet e përgjithshme, të një specifikimi të integruar i parë në kërkesat e sistemit të menaxhimit të botës. Ky standard mundëson për të shfaqur veprimet, aktivitetet dhe procedurat më efektive që janë zhvilluar në përgjigje të kërkesave të tregut drejt shkrirjes në një strukturë të vetme. Sistemi i Menaxhimit të Integruar më shumë se një sistem i menaxhimit, i cili është i gjithë sistemi i institucioneve të formuara duke sjellë së bashku.

Certifikimit Menaxhimi i Integruar i tregon se OE përmbushë të gjitha përgjegjësitë me klientët potencial, furnizuesit, investitorët. Nisur nga kjo është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO PAS 99:2012

2.4.2 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- Materiale termo-izoluese (Sistem Kapote)
- Fino, Koll, Llacra, Stuko etj
- Pajisje hidraulike
- Pajisje hidrosanitare
- Pllaka
- Bojra

Për rastin kur autorizimi dotë jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin(kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe propocion me natyrën, objektin dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Duke marrë në konsideratë e dhe natyrën e punimeve, zërat të cilat kanë volum maksimal të lëndës bazë dhe materialeve të kryerjes së punimeve.Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit te cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet shërbim me “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t'u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.4.3 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë bashkangjitur me kontraten e furnizimit/porosisë me distributorin/prodhuesin, kataloget/skedat teknike si dhe çertifikatat e cilësisë të materialeve/mallrave te shoqeruara me

raportet e testimi nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente me qellim permbushjen e standarteve te kerkuara sipas specifikimeve teknike te meposhtme dhe konkretisht

Për produktet:

- a- **Bojë Akrilike** Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike te paqëndrueshem (VOC), ku emetimi te jete jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000 µg/m³. - ISO 6504-3 ose ekuivalente, lidhur me aftesine mbuluese te bojës, ku fuqia mbuluese te jete ISO 11998 ose ekuivalente lidhur me rezistencen ndaj larjes. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike.
- b- **Boje Hidroplastike** ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN ISO 16000-9:2006/AC:2007 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organikë të paqëndrueshëm (VOC), ku emetimi të jetë jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C < 1000 µg/m³. - SSH EN ISO 6504-3:2007 ose ekuivalente, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës, ku fuqia mbuluese të jetë jo më pak se Klasa e I-rë.- SSH EN ISO 11998:2006 ose ekuivalente lidhur me rezistencën ndaj fërkimit të lagësht, ku rezistenca ndaj fërkimit të lagësht të jetë jo më pak se Klasa e II-të. Certifikim ku të vërtetohet se produkti është boje ekologjike dhe antibakteriale.
- c- **Suva (Llac mbushës)**- Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1. Në rast se është produkt jo i gatshëm të deklarohet receptura përkatëse që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike te kerkuara edhe sipas SSH: EN 998-1.
- d- **Fino** Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1.
- e- **Hidroizolues** Material dykomponentesh me baze çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për terrace, themele, bodrume, etj. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH EN 14891:2017 ose ekuivalente, lidhur me produktet e lëngshme të papërshkueshme nga uji.
- f- **Sistem Kapote** Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike te kerkuara edhe në përputhje me Standardin SSH: EN 13499 ose ekuivalent. Per kete ze Operatori Ekonomik duhet të paraqesi mostren e sistemit kapote, para hapjes së vlerësimit nga KVO përkatëse Mostra duhet te dorëzohet jo më vonë se data dhe ora e hapjes së ofertave.

Kërkesa për mostrën e mallarve është e domosdoshme për shkak të ekzistencës në tregun e brendshëm të mallrave të pacertifikuara, me materiale jo sipas specifikimeve teknike, cka në fakt është dhe qëllimi dhe objektivi i këtij investimi për eficiencën e energjisë në ndertesa.

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.....

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), brenda

afatit 5 (pesë) ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Argumentimi: Në bazë të nenit 4, nenit 36 si dhe nenit 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 .Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertoje të jete i pajisur me certifikatat e mesiperme, të lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoritetit Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës

Në nenin 44 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit

Në nenin 79 pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” citohet shprehimisht

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë.

Kjo kerkese është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit , duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në Specifikimet teknike .

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standardeve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilësie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si

autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës sipas pikës 9, garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në specifikimet teknike.

Gjithashtu në përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt si edhe shërbejnë për ndërtimin e objektit, është marrë në konsideratë një test balancues dhe proporcional në përzgjedhjen e tyre. Kështu është vlerësuar se në përzgjedhjen e grup mallrave të mësipërme të cilat do të vendosen në objekt janë marrë në konsideratë 2 faktorë, volumi i tyre, duke marrë në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Sa më sipër, materialet e sipërcituara zënë një peshë specifike në punimet që do të kryhen në objekt, ndaj kërkesa lidhur me to është në proporcion me natyrën dhe volumin e punimeve. Së dyti, kriteri i marrë në konsideratë lidhet ngushtësisht me faktin se produktet e mësipërme kanë bazë kimike dhe kanë /mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetareve. Akoma më tej vlerësojmë se kemi të bëjmë me një objekte civile ku përpuethshmëria e cilësisë së materialeve të vendosura në objekt nuk duhet të sjellë pasoja shëndetësore në shëndetin e qytetareve, duhet të përmbushë nivelin ekologjik të kërkuar dhe duhet të jetë në përputhje me Standardet e Njohura në Republikën e Shqipërisë.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcio me natyrën dhe volumin e kontratës dhe se i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskriminon midis operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj, pasi standardet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin Europian. Gjithashtu, në përputhje dhe proporcion me vlerën dhe natyrën e kontratës dhe peshës specifike të secilës prej mallrave që do të vendosen në objekt atëherë është parashikuar që për një pjesë prej tyre të dorëohen vetëm katalogjet ndërsa për mallrat dhe paisjet të cilat kanë një ndikim të veçantë në mjedis si edhe ndikim të veçantë në shëndetin e qytetareve, krahas katalogjeve të prodhuesit është kërkuar edhe dorëzimi i raport testeve zyrtare të lëshuar nga laboratorë të akredituar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Gjithashtu, kriteri i mësipërm nuk shfaq diskriminim mes operatorëve të cilët blejnë dhe ofertojnë për kryerjen e punimeve me produkte të gatshëm pasi dokumentacioni i kërkuar me siper disponohet nga cdo prodhues serioz vendas apo i huaj.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike: janë hartuar nga grupi i punës, i ngritur me urdherin perkates në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Në të gjitha raste ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).